



02/Nr. 8882 /2025
20.10.2025

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.08/L-197 në nenin 95,96,97, Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 neni 5 pika c, Ligjit të Punës Nr.03/L-212 neni 8, Rregullore (QRK) nr.27/2024 Për procedurat e konkurrimit për nëpunësit teknik dhe mbështetës Komuna Hani i Elezit shpallë:

KONKURS

Institucioni: Komuna Hani i Elezit

Drejtoria: Drejtoria për Arsim

1.Titulli i vendit të punës: Punëtor/e Teknik/e
njësia/ sektori:SHFMU “Ilaz Thaçi” paralelja Seçishtë
Numri i pozitave: Një (1) pozitë me kohë të pacaktuar
Koeficienti/Grada: GJ50-4.80
Orët e punës: 40 orë

Detyrat dhe përgjegjësitë për Punëtor/e Teknik/e:

- Kujdeset për mirëmbajtjen e objektit në pjesën e jashtme dhe të brendshme;
- Bën mirëmbajtjen e instalimit elektrik, ujin, inventarit dhe pajisjeve tjera të shkollës;
- Në rast të defekteve të mëdha,mbanë kontakte me serviset e specializuara dhe asiston me rastin e riparimeve;
- Bën kyçjen dhe çkyçjen e nxemjes qendrore dhe gjeneratorit elektrik , duke mbajtur edhe evidencën e derivateve të naftës të cilat janë të deponuara në rezervarët e këtyre pajisjeve;
- Mban evidencën, kontrollon dhe monitoron rezervarin e derivateve të cilat janë të vendosura në lokacionin e shkollës;
- Bën mirëmbajtjen e oborrit dhe përkujdeset për lulet brenda dhe rreth objektit të shkollës;

Kushtet e përgjithshme në rekrutim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotëroj të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse.
- Të mos jetë e/i denuar për kryerjen e veprës penale me dashje.
- Të mos ketë fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik

Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit (merret në Komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë)
- Rezumeja personale (CV).
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë kopje).
- Diploma e shkollimit të mesëm (kopje e vërtetuar).
- Certifikata që nuk jeni nën hetime (nga gjykata)
- Certifikatën shëndetësore (pas pranimit në punë)
- Dëshmi të përvojës së punës (nëse ka).

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

Procedura e vlerësimi bëhet sipas Rregullorës (QRK) nr.27/24.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Pranimi i aplikacioneve bëhet mbrenda 15 ditëve nga data 21.10.2025 deri 04.11.2025 nga ora 08:00-16:00

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit mund ti marrin në formë fizike pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati i parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend, apo ti shkarkojnë në portalin shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net>
Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kriteret e konkursit nuk do të shqyrtohen ndërsa në faza tjera do të ftohen vetëm kandidatët që i plotësojnë kriteret e që futen në listë të ngushtë.

Mirë priten aplikacionet e femrave dhe meshkujve të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Nëse kandidatët aplikojnë në dy e më tepër vende të punës, kandidatët duhet të dorëzojnë aplikacione të veçanta për secilin vend të punës.

Konkursi dhe rezultatet shpallen në linkun <https://konkursi.rks-gov.net/>, në web faqen e komunës <https://haniielezit.rks-gov.net/> dhe në tabelën e shpalljes.



**Kryetari i Komunës
Mehmet Ballazhi**

M. Ballazhi